

Mësimi është qysh për



- Shkoni me fëmijën tuaj në një vend për të luajtur dhe në natyrë. Fëmiju duhet të lëvizë intenzivisht.
- Fëmijët që nuk kanë pasur mundësinë që herët të mbledhin përvojë në lojë dhe në lëvizje, mund të kenë më vonë probleme në shkollë!
- Loja me fëmijët tjerë është e nevojshme për mësimin social. Mirëpo është edhe e rëndësishme që ju të bëni mundësisht sa më shumë veprime dhe përjetime me fëmijën tuaj sëbashku!
- **Ne ju dëshirojmë shumë gëzim!**
- Nëse keni pyetje, drejtohuni mjekut të fëmijëve apo mësuesit / mësueses nga foshnjorja apo shkolla.



fëmijët e vegjël
shumë i rëndësishëm!



Fëmiju i vogël mëson më së miri gjatë lojës, gjatë punës së dorës, gjatë punës së përbashkët në shtëpi

- ● ● dhe jo me Kompjuter apo gjatë shiqimit të televizorit ili televizora!

Mësimi i hershëm është i rëndësishëm për suksesin e mëvonshëm në shkollë. Ai fillon që në moshën e fëmijëve të vegjël.

Kështu ju do të pregaditni mirë fëmijun tuaj në shtëpi për në shkollë:



Flisni me fëmijun tuaj në gjuhë amtare!

Është e rëndësishme që fëmiju juaj të flet mirë gjuhën amtare që të mund të mësojë mirë gjermanishten!

të folurit



Lëreni fëmijun tuaj të luaj në kutinë me rërë me ujë, gurrëz, lopatë, gotë etj!

Fëmiju mbledh në këtë lojë (p.sh. gjatë zbrazjes, mbushjes, formimit) dituritë e para të matematikës!

të formuarit



Jepni fëmijun tuaj letër, kutija, shirit ngjitës, gërshtë, ngjitëse etj dhe ndërtoni me të!

Fëmiju mëson lëvizjet e sakta. Fëmiju juaj mund të zhvillojë die dhe fantazi!

të formuarit



Shiqoni me fëmijun tuaj libra me fotografi, tregoni atij përralla dhe tregime!

Kështu fëmiju juaj do të mund më vonë në shkollë më mirë të rrëfejë dhe të shkruaj tregime. Kështu mëson fëmiju juaj të ndëgjojë dhe të koncentrohet mirë!

të dëgjuarit



Lëreni fëmijun tuaj të ndërtojë dhe konstruktojë me kube për ndërtim, lego, kutija, gurrëz etj!
Lëreni të luaj me puzzle!

Fëmiju juaj mëson kështu të mund të njehsojë më vonë! Ai mëson dhe i dallon format, madhësitë dhe sasinë!

të ndërtuarit



Shkoni me fëmijun tuaj në natyrë, tregoni atij gjërat e reja! Ai duhet gjërat edhe t'i prek! Ai guxon në këtë rast edhe të përlyhet!

Fëmiju mëson gjatë prekjes dhe ndjenjës shumë mbi fjalët! Është e rëndësishme për diturinë e mëvonshme në shkollë!

të mësuarit



Emërtoni dhe sqaroni fëmijun tuaj mundësisht shpesh gjërat nga përditshmëria! (p.sh. rrobat, ushqimet etj.)

Një fjalor i gjërë në gjuhën amtare është i nevojshëm edhe për mësimin e mëvonshëm të gjuhës gjermane!

të kuptuarit



Jepni fëmijun tuaj letër dhe ngjyra dhe lëreni atë të ngjyros dhe të formojë!

Fëmiju juaj mëson lëvizjet e krahut, dorës dhe gishtave që më vonë do t'i nevojiten për të shkruajtur!

të ngjyrosurit



Fëmiju juaj duhet që mundësisht herët të mësojë të vishet vet dhe të provojë disa veprime në shtëpi (p.sh. qërimin e mollës, ndihmë gjatë larjes së enëve, shtryerjen e tavolinës etj.)

Një pamvarësi mundësisht e mirë i'a lehtëson fëmijun tuaj ditën shkollore!

të provuarit